



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

---

K.Dh.Sh.II.nr.1313/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “KESCO” Sh.A., me NRB: 71102130 nga Prishtina, kundër debitorit “F-Shped” Sh.P.K, F. N., me adresë në “...”, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Graçanicë, PPPI.nr.15/19 të datës 24.06.2020, me datë 06.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit “F-Shped” Sh.P.K., F. N., me adresë në “...”, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Graçanicë, PPPI.nr.15/19 i datës 24.06.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Graçanicë, me aktvendimin e atakuar PPP.I.nr.15/19 të datës 24.06.2020 ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “F-Shped” Sh.P.K, F. N., me adresë në “...”, Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.183/19 të datës 08.03.2019 të Përmbaruesit Privat Ilir Mulhaxha.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori “F-Shped” Sh.P.K., F. N., me adresë në “...”, përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet

ankesa e debitorit, të ndryshohet aktvendimi i atakuar, ose i njejtë të prishet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesën e debitorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori "KESCO" Sh.A., me datën 08.03.2019, ka paraqitur propozimin për përmbartim ndaj debitorit "F-Shped" Sh.P.K., F. N., me adresë në "...", në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstraktit të verifikuar Nr.DPR-90117739 për periudhën 27.12.2016 deri me datë 16.02.2019 në shumën e detyrimit në vlerën prej 1,856.52 Euro, me kamatë prej 8%, nga dita e kalimit të afatit për pagesë deri në pagesën definitive të borxhit, në llogarinë bankare të kreditorit, si dhe shpenzimet e përmbartimit nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr.183/19 të datës 08.03.2019, e ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori ka ushtruar prapësim duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin me arsyetimin se faturat nuk janë nënshkruar dhe vulosur nga ana e debitorit, dhe se nuk janë regjistruar në librat biznesore të debitorit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri i Përmbartuesit Privat.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka theksuar se debitori në çdo mënyrë provon të shmang dhe prolongon procedurën nga arsye se faturat kinse nuk janë të besueshme dhe se janë shkelur dispozitat e LPP-së. Ka shtuar se debitori ka pranuar të gjitha faturat dhe këtë fakt mund të vërtetohet me shikimin në komunikacionin e tyre nëpërmjet emailit nga data 24.11.2017 dhe se i njejtë nuk kishte asnjë vërejtje deri në momentin e fillimit të procedurës së përmbartimit.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Graçanicë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar PPP.I.nr.15/19 i datës 24.06.2020, me të cilin ka

refuzuar prapësimin e debitorit i ushtruar kundër Urdhrit Përmbarrimor P.nr.183/19 të datës 08.03.2019 të lejuar nga Përmbarruesi Privat Ilir Mulhaxha, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës prapësimi i debitorit është i pabazuar për faktin se debitori theksimet e veta nuk i ka mbështetur me prova përkatëse në formën e shkruar.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbarrimore. Gjykata e shkallës së dytë nga shkresat e lëndës konstaton se Ekstrakti i verifikuar Nr.DPR-90117739 është dokument përmbarrues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarrimit si dhe është në origjinal, prandaj plotëson kushtet ligjore nga nenin 29, pika 1.2 të LPP-së që përcakton se “ *Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.2. “ ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”, prandaj urdhri përmbarrimor ka mbështetje ligjore.*

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i vlerësoi pretendimet ankimore të debitorit se i njëjti nuk ka shfrytëzuar shërbimet elektrike të kreditorit por e gjeti si të pa bazuar, për faktin se në shkresat e lëndës nuk ka prova se në periudhen kohore të përmbarrimit, debitori nuk ka përdor shërbimet elektrike.

Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarrimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi me rastin e kryerjes se përmbarrimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur me këtë të drejtë të tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase pretendimi i tillë nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarrimit në këtë rast.

Përndryshe në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarrimin. Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1313/24 me datë 06.01.2025

Gjyqtari

Krenar Berisha